



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 73

Datë: 29. 10. 2021. Ora: 16:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, krye shef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
2. **Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kryetarë të Komunave të mbajtura më 17 tetor 2021.**
3. **Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**
 - **Raport nga QNR-ja.**
4. **Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.**
5. **Të ndryshme**

1.Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 73-të të KQZ-së. Komisioni është në përbërje të plotë sipas rendit të ditës, e kemi certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për kryetar të komunave të mbajtura me 17 tetor 2021, aktivitetet e sekretariatit me një raport nga QNR, aktivitetet e zyrës dhe të ndryshme. A ka dikush diçka me shtuar lidhur me këtë agjendë ?

Kush është për miratimin e agjendës ?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

2.Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kryetarë të Komunave të mbajtura më 17 tetor 2021:

Kreshnik Radoniqi: Të nderuar të pranishëm, kërkojmë falje fillimisht për vonesë. Sot, është përmbyllur afati i ankesave lidhur me rezultatet përfundimtare që një ditë më herët janë shpallur nga KQZ para se të procedojmë me certifikim të rezultateve gjatë ditës së sotme kemi komunikuar me dy institucione PZAP dhe Gjykatën Supreme. Nga këto institucione, kemi marrë konfirmimet se rezultatet e cilave komuna nuk mund të certifikohet pasi ka ankesa dhe shqyrtimi i tyre nuk ka përfunduar ende prandaj, ne sot kemi në rend të ditës certifikimin e rezultateve përfundimtare të raundit të parë të zgjedhjeve lokale për kryetar të 35 komunave. Pra, pjesë e certifikimit të sotëm nuk janë rezultatet e raundi të parë të zgjedhjeve për kryetar të komunës së Shtimes, Ferizajit, Podujevës dhe Klllokotit ndërsa për komunat tjera janë, vazhdojmë me rend. Kemi certifikimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për kryetar komune:

Certifikohen rezultatet në këto komuna: Deçan, Glllogoc, Gjakovë, Gjilan, Dragash, Istog, Klinë, Kaçanik, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Skënderaj, Shtërpce, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveqan, Malishevë, Junik, Mamushë, Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Mitrovicë e veriut.

Me 9 vota për (Alim Rama nuk merr pjesë në votim, dhe anëtarë Sami Kurteshi voton kundër), certifikohen rezultatet. Do të presim edhe për komunën e Hanit të Elezit! Sa për njoftim Gjykata Supreme ka marrë sot vendimin për Hanin e Elezit, aktgjykimi AA56 -21 i datës së sotme me të cilën janë refuzuar ankesat e

kandidatit të pavarur Rufki Suma. Meqenëse aktgjykimin e kemi marrë pak me vonesë, nuk jemi bërë gati për certifikim por, në ndërkohë na sjellin vendimin për Hanin e Elezit. Para se me fillue, Burim a mundesh me na dhënë një njoftim për Hanin e Elezit...?

3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

Raport nga QNR-ja:

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të KQZ-së, para jush i keni 4 raporte te cilat janë raporte për të cilat nevojitet vendimmarrje e KQZ-së në mënyrë që të procedohet më tutje në QNR e që ka të bëjë me votat për asamble komunale, më konkretisht me mospërputhje te votat për kandidatë , më lejoni para jush të bëj një prezantim të shkurtë të aktiviteteve të sekretariatit më pastaj do të kalojmë për secilin raport veç e veç për të cilën do të na duhet vendimmarrja e KQZ-së , periudha e votimit jashtë Kosovës raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune ka filluar me datën 14 nëntor periudhë përmes së cilit të gjithë votuesit jashtë Kosovës të cilët janë regjistruar suksesshëm pra fillon me datën 29 tetor 2021 dhe përfundon deri me datën 12 nëntor 2021. Divizioni i shërbimit votues përmes imellë adresës ju ka dërguar informata të gjithë votuesve të cilët janë regjistruar suksesshëm për komunat ku do të zhvillohet raundi i dytë duke informuar me gjithë informatat e nevojshme si dhe po ashtu me fletëvotime dhe përmbajtjen e fletëvotimit të cilin mund ta printojnë nga ueb faqja apo nga lokacionet ku janë dhe të njëjtin mund ta plotësojnë dhe ta fusin në zarf së bashku me dokumentet , aktivitetet tjera janë në QNR dhe siç, e thash më herët jemi në procesi e përpilimit faktikisht jemi në procesin e kontrolleve të bazës të të dhënave me qëllim që ti kemi rezultatet e sakta për asamble komunale dhe më saktësisht për kandidatët që kanë garuar për secilën komunë me subjektet e tyre politike.

Po ashtu, në raport keni edhe progresin por është dashur të kompletohen të gjitha formularët e rezultateve qoftë për subjekte politike po ashtu edhe për kandidatë në bazën e të dhënave në mënyrë që të kontrollohet dhe të kemi saktë dhe mos të kemi shmangie të ndonjë vendvotimi pra që të bëhet kontrolli përkundrejt votave të subjekteve me vota të kandidatëve. Një ndër detyrat që ka pasur QNR ka qenë edhe verifikimi i të dhënave të shënuara në fletat llogaritëse të kandidatëve dhe si rrjedhojë nga fletat llogaritëse të kandidatëve të gjenerohen rezultatet për kandidatë të cilat duhet të shënohen në formular të rezultateve të kandidatëve. Ky kontrollim, është bërë në masën 10 % për secilën komunë sipas metodës së rastësishme dhe lista është krijuar sipas metodës së rastësishme para se të fillojë procesi i pranimit të gjithë materialit të ndjeshëm në QNR dhe QNR ka bërë verifikimin dhe kontrollin e të gjitha të

dhënave që janë shënuar në fletat llogaritëse të kandidatëve përkundrejt atyre që janë shënuar në formular të rezultateve. Nga ky verifikim, rezulton se nga 225 vendvotime rezultatet janë shënuar saktë në formularë të rezultateve të kandidatëve në 63.53 % që nënkupton që prej 255 vendvotimeve në 162 vendvotime janë shënuar saktë rezultatet si në fletat llogaritëse të kandidatëve po ashtu edhe në formularë të rezultateve të kandidatëve. Prej kësaj liste prej 255 vendvotimeve, dy vendvotime kanë qenë të rinumëruara paraprakisht me vendimin e KQZ-së për shkak të arsyeve të cilat kanë qenë dhe në bazë të cilave ka marrë vendim edhe KQZ për rinumërim të tyre, ndërsa prej 255 vendvotimeve në 76 vendvotime është gjetur se ka gabim teknik në bartjen e rezultateve nga fletat llogaritëse të kandidatëve në formularë të rezultateve.

Nëse më lejoni, është tabela që është para jush që është shpërndarë edhe te ju në imellë pra raporti i verifikimit të votave në formularë të rezultateve të kandidatëve është raport që i përmban 255 vendvotime dhe është diku rreth 13 faqe i gjatë raporti dhe përshkruan në detaje secilën të gjetur nga procesi i verifikimit prej formularëve të rezultateve pra nga gabimi teknik janë 76 vendvotime që kanë bërë gabim teknik në bartje dhe në përqindje është 29.80 % , kategori tjetër është gjetur mospërputhje të votave në mes të fletave llogaritëse të kandidatëve dhe formularëve të rezultateve të kandidatëve ku nga 255 vendvotime që janë; dhe hetuar janë 14 vendvotime të cilat kanë këtë mos përputhje dhe në përqindje janë 5.49 % ndërsa në një vendvotim e kemi gjetur se nuk janë bartur votat nga fleta llogaritëse të kandidatëve në formularë të rezultateve të kandidatëve.

Pra, në masën 0.39 % lidhur me këtë kemi sjellë para jush edhe tri rekomandime të cilat kanë të bëjnë me kategorinë për bartje pra gabim teknik në bartje të rezultateve ku rezultatet në formularë të rezultateve të kandidatëve të vendvotimeve në të cilat ka pasur gabim teknik në bartje të votave nga fletat llogaritëse të kandidatëve në formularë të rezultateve të kandidatëve e në të cilat është evidentuar se ka vota më shumë apo më pak. Në raport, e gjeni të specifikuar në kolonën e parafundit për secilin subjekt se sa ka vota më shumë e më pak e në shumicën e rasteve më shumë se 90 % rezulton se kandidatët kanë një votë ose kanë në fletën llogaritëse të kandidatëve ndërsa në formularë të kandidatëve kanë 0 vota ose e kundërta pra lidhur me këtë rekomandohet KQZ që të rinumërohen fletëvotimet vetëm për atë subjekt pra si në listë për secilën kategori dhe rezultatet pas rinumërimit të përfshihen në rezultatet përfundimtare.

Kreshnik Radoniqi: Shkojmë rekomandim për rekomandim por meqenëse ma sollën Hanin e Elezit, po e përfundojmë Hanin e Elezit edhe po vazhdojmë...

Për komunën e Hanit të Elezit, kryetar është zgjedhur Mehmet Ballazhi nga PDK me 51.33 %.

Kush është për ? Certifikohet rezultati për Hanin e Elezit. Do të thotë, tash na kanë mbetur vetëm 4 komuna pa u certifikuar: e kemi komunën e Shtimes, Ferizajit, Podujevës dhe Klllokotit për të cilat presim vendimmarrjen e PZAP-it apo Supremes.

Arianit Elshani: Lidhur me rekomandimin e sekretariatit që të rinumërohen vetëm fletëvotimet e atij subjekti politik në të cilin janë gjetur gabime në bartje, rekomandoj se si KQZ për të gjitha këto kuti të votimit të cilat ne i hapim të bëhet një rinumërim i plotë pavarësisht se subjektet tjera në krahasim nuk janë shumë bëhet fjalë pra për 76 vendvotime të cilat duhet të rinumërohen. Prandaj, mendoj që do të ishte më mirë që të bëhet një rinumërim i plotë i votave për kandidatë për kuvend komunal sepse, e dimë që krahasimin që e kemi bërë mes flikave dhe FRK-të të subjektet tjera mund të ketë dalur mirë. Pavarësisht kësaj, edhe kjo është një lëshim i kryesuesit të atij vendvotimi që mund të ketë qenë edhe teknik por rekomandoj që ti vendosim të gjitha në rinumërim.

Burim Ahmetaj: Atëherë, në baze të kësaj në faqen 3 e kemi tre kategori pra gabime teknike në bartje kane qene 76 vendvotime mos përputhje e votave mes fletave llogaritëse të kandidateve dhe FRK-vë 14 vendvotime dhe nuk janë bartur votat në FRK-ë të cilat kane qene 3 rekomandime tani më propozimin shndërrohen në një rekomandim që nënkupton që gjitha këto vendvotim të rinumërohen dhe në total janë 91 vendvotime sipas listës.

Kushtrim Radoniqi: Atëherë a pajtoheni më rekomandimin e z. Elshani. Urdhëro Alim ?

Alim Rama: Unë mendoj që kjo mundet më ndikuar edhe të subjektet tjera. Unë, jam i shqetësuar në përqindje të madhe prej këtyre 255 kutive, na dolën me probleme me 34 kuti. Tani, sigurisht që unë kisha kërkuar sekretariatit më ba edhe një analize dhe të shohim pas këtij rinumërimi, sepse kjo është një përqindje shumë e lartë për një mostër 30%.

Florian Dushi: Po besoj mbi bazën e asaj që na ka rënë secilit prej neve këtu që, të dëgjojmë ditëve të fundit, sidomos ankesat edhe vërejtjeve që kandidatet kane pasur lidhur më përshkrimin e sakte ose të pa sakte të votave të tyre dhe mbi bazën e asaj çfarë kemi parë në rinumërimet që tashme kanë ndodhur tek ne! Konsideroje se nuk ka asgjë të keqe nëse kutit numërohen në tersi dhe jo vetëm tek subjektet politike të cilat janë gjetur gabime sepse, secili rinumërim praktikisht, rezultati është i korrigjuar apo rezultati është saktësuar ashtu si qytetaret tanë kane votuar. Prandaj, meqë do të hapen kutitë e votimit, unë konsideroje se nuk ka asgjë të keqe që jo vetëm tek subjektet politike që janë gjetur lëshimet por, të rinumërohen të gjitha fletëvotimet brenda kutisë së votimit.

Ilir Gashi: Po mendoj se nga ajo që po shohim këtu, ka nevojë edhe për një analizë të thellë sepse edhe këto bartjet nuk janë të vogla ne kemi të gjitha subjektet politike kemi deri 20 e më shumë kështu që duhet mu pa a janë krejt teknike apo edhe ka pasur ndonjë tendence. Sa i përket propozimit, po mendoj që duhet të rinumërohen të gjitha edhe për faktin se mund të kemi ankesa pastaj të këta kandidatëve të ndryshëm dhe ne, me këtë edhe i evitojmë rinumërimet e reja d.m.th, pra, në kohë fitojmë edhe vijmë më shpejt edhe tek shpallja e rezultateve...

Sami Kurteshi: Unë, pajtohem më këtë pikë më rekomandimin që numërohen gjitha fletëvotimet në vendvotime sepse ato çka janë vrenjte janë vrenjte por ka mundësi që të jete ndryshe. Për mua, është shumë shqetësues përbindja e madhe e gabimeve. Sigurisht, ka me qenë detyrë e KQZ-së por edhe ndryshimit të ligjit por edhe ndryshimit të rregullave, dhe unë mendoj se ka ardhur koha kur ne duhet me menduar seriozisht çka, është me trajnimin...!? A është i mundur që edhe trajnimi jonë nuk ka qenë i duhur me i bo gjithë këto lëshime. Tani, nuk po flas vetëm për një subjekt vetëm se, i pame tabelat edhe siç duket nuk ka përjashtim, natyrisht duket që ka më shumë bartje të votave te partitë më të mëdha por, sidoqoftë ka gjithkund...Pra, është çështja e trajnimeve, e dyta çështja e përgjegjësive, çështja e përbërjes së komisionarëve dhe ajo sigurisht ka më qenë çështje e ligjit por, unë po e them sinqerisht: çdo kush tani që ban një lidhje me mundësin e bartjes së ndonjë vote sepse ka më pasur ankesa, sidomos të kandidatëve për kuvende komunale që mund të bijnë për një votë edhe për dy vota; edhe ata kane pritjet e tyre, kane shpresat e tyre por edhe kur e kemi këtë shkalle të gabimeve, çfarëdo qofshin teknike apo lëshime të qëllimshme, kishte më qenë e padrejtë mos të ju numërohet ankesa, sidomos krejt atyre që për një votë ose dy vota munden mos me mbete në garë...

Ibrahim Selmanaj: Faleminderit kryesues, nuk është krejt pa shqetësim kjo situatë sepse, edhe mospërputhja e rezultateve, formularëve kjo po shihet që është bartje në të gjitha subjektet politike...! Rinumërimi, është ajo që i qartëson dhe sill rezultatin faktik. Kemi të bëjmë më përfundimin e një rezultati që bajagi është investuar që të ketë rezultat të suksesshëm dhe zgjedhjet të dalin tamam një pasqyre reale qysh qytetari ka vendosur dhe dëshiron me e pasur rezultatin! Bëhet fjale për njerëz që nuk janë, që kanë votuar por edhe ata që pretendojnë që të jenë të zgjedhur edhe në rast kur i mohohet qoftë edhe një votë...! Atëherë, ne jemi para përgjegjësisë dhe duhet të japim llogari në këtë drejtim duke qenë se investon gjithë shoqëria të ketë zgjedhje të suksesshme. KQZ ka një marrëveshje bashkë me institucionet e tjetra dhe me mekanizmat tjerë që janë prokuroria, drejtësia, policia dhe arsimiti. Unë mendoj se duhet të jene efikas këtë drejtim, shumë efikas të jenë të gjithë...

Florian Dushi : E kam një propozime që ndërlidhet më ketë! Siç po shihet, i gjithë vullneti dhe disponimi i gjithë anëtareve këtu është që të rinumërohen të gjitha këto vendvotime të cilat për arsye të ndryshme, ka edhe mos përputhje - ka edhe lëshim e gabime teknike, prandaj unë po e shohë që në fakt, përveç tendencave për manipulim këtu, kemi edhe një fare niveli të papërgjegjësive së këtyre trupave sepse, e shohim se nëse e marrim vetëm Prishtinën, i kemi rreth 20 vendvotime të cilat disa subjekte politike ose disa kandidatëve të subjekteve politike, nuk janë përshkruar as edhe me një votë të vetme; Thjeshtë kanë heq dorë...

Ndërkohë që stafet trajnohen dhe paguhen nga subjektet politike për të përshkruar secilën votë që gjendet në kutin e votimit prandaj, unë lidhur më ketë e kam një propozime meqë më 14 nëntor do të kemi rundin e dytë të zgjedhjeve: pra, propozojë si KQZ-ë që të evidentohen të gjitha këta këshilla të vendvotimit ku kemi probleme dhe te përjashtohen, mos të lejohen në rundin e dytë që të njëjtit të kenë njëjtën përgjegjësi dhe të na sjellin deri në ketë nivel të rinumërimit...

Sami Kurteshi: Unë pajtohem plotësisht që çdo këshill i vendvotimit që ka pasur probleme që është identifikuar me problem të evidentohet nga KQZ-ja dhe në qofte se partitë politikë i delegojnë, ne mos me i pranuar! Ne, e kemi këtë të drejtë...dhe, të mos lejojmë njerëz që janë të pa përgjegjshëm në proces...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit. Atëherë, lidhur më rekomandimin e pare më modifikim të propozuar nga z. Elshani, kush është për ?

Më vota unanime miratohet rekomandimi i parë.

Burim Ahmetaj: Atëherë, në bazë të tabelës, e keni rekomandimi i parë, të dytë dhe të tretë. Të gjitha përfshihen me një rekomandim dhe janë 91 vendvotime të cilat, mori vendim KQZ-ë që të rinumërohen si rezultat i krahasimeve dhe mos shënimit saktë të votave duke krahasor formularët e rezultateve të kandidatëve më fletat llogaritëse të kandidatëve. Ndërsa, kalojmë tek rekomandimi i katër dhe i pestë. Rekomandimi i katër ka të beje më një mase më të madhe të shkeljeve apo më mire më thanë mos shënimit të sakte të votave për kandidatë.

Në bazë të procedurave e bëjmë kontrollin e bazës së dhënave dhe janë kriteret baze të cilave i bëjmë këto kontrole. Një nder kriteret është kur shohim që kandidati ka më shumë vota sesa subjekti duke krahasuar votat e subjektit më votat e gjithë subjektit mirëpo, në raste të caktuara kemi kur një kandidatë ka më shumë vota sesa krejt subjekti. Kriter tjetër është kur kontrollojmë të gjitha votat e kandidatëve dhe kemi raste kur të gjithë kandidatet së bashku, kanë më shumë vota sesa subjekti që i ka. Kategoria

tjetër është kur subjekti ka vota dhe kandidatet kane zero vota dhe kategoria e fundit që kemi berë, është kur subjekti ka zero vota dhe kandidatët kanë vota.

Pra, kjo bëhet duke krahasuar rezultatet e subjekteve politike në formularë të përputhjeve të të dhënave dhe rezultateve me votat e secilit subjekt në formularët e rezultateve, dhe si rrjedhojë të saj kemi tri kategori për të cilat nevojitet të merret rinumërim për votimin e tyre.

Kategoria e pare kur subjekti në formularët e përputhjeve se rezultateve ka vota dhe në formularë të rezultateve të kandidateve nuk ka vota. Dhe lidhur më këtë në liste e keni 57 vendvotime mirëpo janë disa vendvotime që janë të njëjta dy ose tri subjekte dhe në total janë 50 vendvotime për këtë kategori. Kategoria e dyte është kur subjekti në formularët e përputhjes së dhënave dhe rezultateve ka zero vota kurse kandidatet kane vota.

Në këtë kategori janë 12 vendvotime. Kategoria e tret e cila ka numrin më të madh të mos përputhjeve ka te beje kur kandidati apo gjithë kandidatet kane vota më shumë sesa subjekti. Dhe numri i tyre është 138 vendvotime.

Pra, nga kjo rezulton që behet fjale rreth 200 vendvotime për të cilat rekomandohet KQZ-ë që për rezultatet në FPR dhe FRK-ë të zgjedhjeve për kuvendin komunal. Rekomandohet që të gjitha këto vendvotime si në liste të rinumërohen. Mirëpo më lejoni edhe një detaj të ju njoftoj që mund të ketë vendvotime që janë në 3 kategoritë.

Kreshnik Radoniqi : Arianit Elshani ?

Arianit Elshani: Unë në këtë rast nuk e di se si e ka planifikuar sekretariati mirëpo mendoj që këto rekomandime të shkojnë ashtu sic shkoje rekomandimi i kaluar që të kemi një rinumërim të plote të gjitha këtyre kutive që hapen e di që behën fjale për 183 kuti, prandaj mendoj që duhet të rinumërohen në tersi për secilin subjekt politike. Prandaj rekomandoje që edhe këto rekomandime të shkojnë në rinumërim të plote për secilën subjekt politike.

Sami Kurteshi: Ne, pak më parë në rekomandim morëm vendim që aty janë 91 vendvotime, prej këtyre mund të ketë edhe këtu por pa i bashkuar sa janë në tersi totali i dy kategorive.

Florian Dushi: Pavarësisht asaj qe thatë, mund të jetë në dy apo tri kategori d.m.th, kështu siç është mund të jete më e ulte shifra...

Burim Ahmetaj: Shifrat aktuale 291 dhe një rekomandim i cili do jetë për një vendvotim, më pastaj. Këto 3 kategori, mund të jenë në liste njëra me tjetrën. Do ta bëjmë listën për secilën këto vendvotime edhe për secilën do të japim përshkrimin dhe do të ja dërgojmë juve me email verifikimin e 10% është fjala kur subjekti ka 0 vota dhe kandidati ka vota, është fjala ku subjekti ka vota dhe kandidatet kanë 0 vota dhe rasti kur një kandidat apo të gjithë kandidatet kanë më shumë vota sesa subjekti. Të gjitha këto do të grumbullojmë më një tabelë do të japim përshkrimin dhe numri ndoshta do të jetë më i vogël sesa 292 kuti.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për miratimin e rekomandimit ? Me vota unanime, aprovohet rekomandimi.

Burim Ahmetaj: Formulari i vendvotimit për votat nuk ka mund të procedohet si i rregullt për shkak se ka pasur mos përputhje mes të dhënave në formular rezultateve dhe fletëvotimeve brenda kutisë, dhe për këtë vendvotime rekomandohet që të numërohet i plotë...

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka më këtë rekomandimin e fundit ?

Kush është për ? Me vota unanime aprovohet edhe rekomandimi i peste (5) i sekretariatit.

Burim Ahmetaj: Atëherë, sipas këtyre shifrave, pasi të bëhet kontrolli dhe përfshirja e të gjitha vendvotimeve, kategorizimi i tyre sigurisht që tani është 292 me shifër, por ky numër mund të jetë më i vogël. Po ashtu, kemi përcjell edhe një raport tjetër i cili e bën krahasimin e rezultateve para dhe pas rinumërimit dhe e keni nëse mund të gjeni; keni raportin ku fletë për ndryshimin e votave para dhe pas rinumërimit dhe ajo çka është shqetësuese është se ka ndryshime të votave pas rinumërimit në votat e subjekteve përveç mos përputhjeve të dhënave për fletëvotime të cilat mund të jenë edhe proceduralisht gabime njerëzore. Mirëpo, ajo çka është më shqetësuese është ndryshimi i rezultateve në formularë të përputhjeve të dhënave dhe rezultateve për kuvendin komunal.

Kreshnik Radoniqi : Faleminderit z. Ahmetaj, nëse s'ka dikush diçka?

Arianit Elshani: Faleminderit shumë për këtë raport se vërtetë po vërehet baza e këtij raporti që ka ndryshime të votave të kandidateve, subjektive politike në raport me votimin që ka ndodhur në klasë gjatë ditës së zgjedhjeve dhe më pastaj, si janë evidentuar këto në QNR-ë. Prandaj, ne kemi një rregull zgjedhore ku përcaktojmë një luhatshmeri të votës deri më 3 vota plus minus por edhe ato më pare i dërguam rinumërim të plote pavarësisht gabimeve teknike që mund të jenë; Ndërsa, sa i përket këtyre

diferencave të mëdha që po i shoh 7 vota, 4 vota, 23 vota, 71 vota...Pra, konsideroje që gjitha këto duhet të procedohen menjëherë për hetim atu ku keni pare ju që nuk ka gabime teknik.

Ju, e keni një vendvotime në Prishtinë që është vrenjtë që diferenca është të gjitha subjektet politikë por edhe ajo duhet të evidentuar. A ka qene një gabime apo lëshim nga komisionarët dhe kryesuesi i atij vendvotimi apo ka qen e qëllimshme, dhe njëjtë në raport me gjitha vendvotime në gjithë Kosovën. Pra, këto menjëherë pas përfundimit të raporteve që keni në QNR duhet të procedohen menjëherë për hetuesi....

Florian Dushi: Po më intereson tani këtë raportin që kemi marr nga këto vendvotime të rinumëruara; Ne, praktikisht kemi dy palë rezultate: tani kemi rezultatet nga vendvotimi dhe rezultatet të cilat ka prodhuar rinumërimi në qendrën tonë të numërimit të rezultateve. Prandaj, dua më pyete krye shefin se a është e paraparë më procedura që ne duhet me marr vendim për më i njohtë rezultatet që i ka prodhuar QNR-ja apo, këto vetvetiu konsideroni fakt i kryer...?

Burim Ahmetaj: Nuk shihet në procedurë që këto rezultate pas rinumërimit të miratohen me vendimin e KQZ-së, por nënkupton që këto rezultate duhet të rinumërohen dhe të njëjta rezultate të konsiderohen finale dhe të përfshihen në rezultatet përfundimtare.

Kreshnike Radoniqi: Faleminderit Burim.

Sami Kurteshi: Megjithatë, ne po bisedojmë edhe po shohim fundin ku kemi situar gjithçka edhe përsëri s'po na jetë diçka dhe ky është problem për mua dhe shqetësim shumë i madh; Shqetësim shumë i madh më i thanë një njeriut që ti nuk ke të drejt me ba një ankesë se të mungon një votë! Unë, kam këtë shqetësim, ne duhet mu bë transparent deri në fund, gjithçka me treguar në publik, le të shohin publiku se ku është gjendja. Ne, kemi bërë përpjekje me i organizuar mirë dhe ne nuk mundemi me kaluar këtë fazë vetëm ashtu thjeshte: as ne, as prokuroria. Ne, nuk mundemi më i mbylle sytë, kjo është e dhimbshme sepse unë për vete e ndjej veten fajtorë para një personi që më thotë nuk kam hy në kuvend sepse, dikush më ka bërë hile...Unë, e kam për detyre që kjo çka ndodh me qenë korrekte para ligjit, me qene transparente deri në fund...

Burim Ahmetaj: Më proceduar më tutje, ishe propozimi i z. Dushi dhe pajtueshmëria e gjithë anëtareve të KQZ-së që gjithë ata trupa zgjedhor të cilët kanë qenë të përfshire në të gjitha rinumërimet të identifikohen...

Florian Dushi: Tani, ne u pajtimi dhe KQZ-ja e dha pajtimin për këtë! Unë, mendoj që KOZ-ë do të këtë parasysh këtë bashkë me komisionet komunale të zgjedhjeve, pra në këtë fazën ku ne jemi në prag të riemërimit të këshillave të vendvotimit ose të konfirmimit prandaj, po mendoj që të funksionon këshilli me këtë qëndrim, po them që KQZ të marrë vendimin finale kur i nxirr jashtë...

4.Aktivitetet e ZRPPC-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:

Yll Buleshkaj: Ashtu siç jemi autorizuar nga KQZ-ë, i kemi njoftuar të gjithë vëzhguesit për vendimin e KQZ-së lidhur me akreditimin e vëzhgueseve shtesë për vëzhgim të rëndësishëm të dytë apo, për nevojën për konfirmime të vëzhguesve të subjekteve politike dhe OJQ-të. Nga ky proces, tashme kemi marr përgjigje nga shumë OJQ, ndërsa nga partitë politike ende presim. Po ashtu, jemi në përgatitje të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për dosjen e informimit publik të cilat, do të jenë të gatshme atëherë kur dorëzohen edhe raportet financiare të partive politike për fushatë...

Ndërsa rekomandimi specifik që keni para jush, është rekomandimi për dy vëzhgues shtesë nga misioni diplomatik i Shteteve të Bashkuara në Kosovë ku, kanë aplikuar edhe për akreditimin e dy vëzhgueseve të cilët i kanë plotësuar të gjitha kriteret ligjore dhe rekomandojmë para juve.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për akreditimin ? Më vota unanime akreditohen dy vëzhgues nga SHBA në Prishtinë për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve për rundin e dytë.

5.Të ndryshme !